# FUSHATA AFTERCARE 2026

## TAKIME DOOR-TO-DOOR ME KOMPANITË ME KAPITAL GJERMAN, ITALIAN, AUSTRIAK, HUNGAREZ, HOLLANDEZ DHE ZVICERAN

QERSHOR 2026



## 1 QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi Aftercare 2026 synon krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm komunikimi dhe bashkëpunimi me investitorët e huaj në Shqipëri. Ai fokusohet në identifikimin dhe adresimin e problematikave që ndikojnë në aktivitetin e tyre, si dhe në përmirësimin e klimës së biznesit për të nxitur investime të reja dhe zgjerimin e atyre ekzistuese.

## 2 AKTIVITETET KRYESORE

Programi mbështetet në një qasje proaktive dhe të koordinuar ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat. Në këtë kuadër parashikohen:

- Takime "door-to-door" me kompani të përzgjedhura me kapital të huaj në Shqipëri
- Fokus te investitorët nga: Gjermania, Italia, Austria, Hungaria, Holanda dhe Zvicra
- Diskutime të drejtpërdrejta mbi: -përvojën e tyre në Shqipëri -sfidat dhe problematikat ekzistuese -planet për zgjerim dhe investime të mëtejshme

## 3 ZGJERIMI I PROGRAMIT

Përveç këtij grupi fillestar, programi do të zgjerohet edhe përmes takimeve sektoriale dhe gjithëpërfshirëse me investitorë nga vende të tjera, me qëllim zgjerimin e shtrirjes së mekanizmit Aftercare dhe forcimin e dialogut me më shumë kompani ndërkombëtare

**TAKIMET E PROGRAMIT DO TË ZHVILLOHEN ME MBËSHTETJEN E:**

- Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit
- Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor

## 4 BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL

Një komponent i rëndësishëm është përfshirja e pushtetit vendor, për shkak të rolit të tij në çështje si infrastruktura, shërbimet publike dhe procedurat administrative. Në këtë kuadër, AIDA ka nënshkruar 12 Memorandume Mirëkuptimi me bashki të ndryshme në Shqipëri, për të rritur bashkëveprimin dhe mbështetjen ndaj investitorëve.

**12 MEMORANDUME MIRËKUPTIMI**
NË BASHKI NË SHQIPËRI

## 4 KOMPONENTI DIGJITAL

Programi përfshin gjithashtu krijimin e një platforme online të dedikuar, e cila do të shërbejë si pikë kontakti për investitorët, duke mundësuar komunikim në kohë reale, raportim të problematikave dhe ndjekje institucionale të tyre.

| KOMUNIKIM NË KOHË REALE | RAPORTIM I PROBLEMATIKAVE | NDJEKJE INSTITUCIONALE | TRANSPARENCË DHE EFEKTIVITET |
|---|---|---|---|

## 4 REZULTATI I SYNUAR

Qëllimi final është forcimi i marrëdhënieve afatgjata me investitorët ekzistues, përmirësimi i klimës së biznesit dhe rritja e besimit për të nxitur zgjerimin e investimeve të huaja në Shqipëri.

| MARRËDHËNIE AFATGJATA | KLIMË BIZNESI MË E MIRË | BESIM MË I LARTË | ZGJERIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA |
|---|---|---|---|